



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1483/4 prot

Datë 06.07.2023

**V E N D I M**

**Nr.575/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.07.2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-73075-06-20-2023 me objekt “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 07.07.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumes.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Universitar i Traumës  
Rruga “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK  
Rr.“Vllazën Huta”, Pallati i Ri “Vila Park”, 1/6/25,Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave*

*për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-73075-06-20-2023 me objekt “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 07.07.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumes.

II.2. Në datën 27.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ankesa e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/3208, protokolluar me nr. 1483/2023 prot., datë 27.06.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 1615/2 prot., datë 03.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1483/2 prot., datë 05.07.2023 me objekt “*Informacion*”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Publik informacion në formë shkresore dhe elektronike (CD) në lidhje me procedurën e prokurimit, formularin e ankesës së OE, si dhe bashkëlidhur ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 1615/1 prot., datë 03.07.2023, me objekt “*Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik*”, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...]”

Pretendimi Nr.1 mbi specifikimin teknik”*Bllokim automatik pas 60 sek*”

*Bllokimi 60 sek është konsideruar si koha maksimale që duhet të bllokohet.*

Pretendimi i OE qëndron pjesërisht. *Ky specifikim modifikohet si vijon: “Bllokim automatik pas jo më vonë se 60 sek”.*

*Për sa më sipër ankesa do të merret parasysh.*

Pretendimi Nr.10 “Afati i lëvrimit”

*Te gjithë mallra/paisjet duhet te furnizohen brenda nje muaji duke filluar nga data e nënshkrimit te kontratës se furnizimit sipas Marrveshjes kuadër per periudhën 12 mujore.*

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar si kohë optimal, por nisur nga pretendimi i OE, KSHA vlerëson se koha e lëvrimit prej 45 ditësh është e pranueshme.*

*Sa më sipër pretendimi i OE qëndron dhe do të merret parasysh.*

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 1615/2 prot., datë 03.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1483/2 prot., datë 05.07.2023 me objekt “*Informacion*” autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Publik informacion në formë të shkruar dhe elektronike (CD) në lidhje me procedurën e prokurimit, formularin e ankesës së OE, si dhe bashkëlidhur ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 1615/1 prot., datë 03.07.2023, me objekt “*Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik*”, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...]”

*Pretendimi Nr.1 mbi specifikimin teknik ”Blokim automatik pas 60 sek”*

*Blokimi 60 sek është konsideruar si koha maksimale që duhet të bllokohet.*

*Pretendimi i OE qëndron pjesërisht. Ky specifikim modifikohet si vijon: “Blokim automatik pas jo më vonë se 60 sek”.*

*Për sa më sipër ankesa do të merret parasysh.*

*Pretendimi Nr.10 “Afat i lëvrimit”*

*Te gjithë mallra/paisjet duhet te furnizohen brenda nje muaji duke filluar nga data e nënshkrimit te kontratës se furnizimit sipas Marrveshjes kuadër per periudhën 12 mujore.*

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar si kohë optimal, por nisur nga pretendimi i OE, KSHA vlerëson se koha e lëvrimit prej 45 ditësh është e pranueshme.*

*Sa më sipër pretendimi i OE qëndron dhe do të merret parasysh.*

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

*Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin*

*dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-73075-06-20-2023 me objekt “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 07.07.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumes.
  2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
  3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**